



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 08.03.2023 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: Pro Tech Clean SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës”**, me Nr. të Prok: **616-23-781-2-1-1**, **Autoriteti Publik – Komuna e Prishtinës me datë: 09.03.2023** nxjerr:

V E N D I M

- Hudhet poshtë si e palejuar kërkesa për ri shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: Pro Tech Clean SH.P.K e parashtruar me datë: 08.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616-23-781-2-1-1, kundër *Njoftimit për Kontratë* të AK -së, të datës 10.02.2022 të publikuar në web-faqe të KRPP-së, në bazë të nenit 108/A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.**
- Autoriteti Kontraktues ka shqyrtues kërkesë për rishqyrtim të ngjashme të OE ankimor me datë: 01.03.2023 dhe ka ngritur në platformë elektronike E-Prokurimi sqarimet për të gjitha pretendimet 24.02.2023**
- Autoriteti Kontraktues, mbështet vendimin për të vazhduar lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616-23-781-2-1-1.**
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>**

Andaj në bazë të asaj se çka është cekur në arsyetim, Autoriteti Kontraktues ka vendosur si në dispozitivin e lartcekur.

Iu dorëzohet:

Departamentit të Prokurimit

Palës përmes sistemit elektronik - E-Prokurimi

Arkivit

Visar Shehu – U.D. – Departamenti i Prokurimit

